

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË UEBINARIN “DREJT NJË DIALOGU MË
TË MADH NDËRKULTUROR, NDËRBESIMTAR DHE NDËRFETAR NË
BALLKANIN PERËNDIMOR”**

3 shkurt 2021

Është kënaqësi shumë e madhe për mua të marr pjesë në këtë uebinar i cili i kushtohet kësaj teme gjithnjë e më të rëndësishme për shoqëritë e të gjithë botës: bashkëpunimi ndërkulturor, ndërfetar dhe ndërbesimtar.

Me lejon ta nis fjalën duke falënderuar Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH) për ftesën, si dhe ata që kanë mbështetur këtë nisëm: DRA-në, Platformën e Solidaritetit Qytetar dhe Gjermaninë.

Ndodhem këtu në kapacitetin e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe, me lejen tuaj, kam ardhur si njeri vërtetë i interesuar për këtë temë shumë të rëndësishme diskutimi.

Ndjej privilegj që shërbej në Shqipëri, që jetoj dhe punoj në mes të qytetarëve këtu. Shqipëria është model i demokracisë toleruese, ku qytetarë që u përkasin besimeve të ndryshme fetare jetojnë në paqe së bashku, ku takime si ky i sotmi, të cilët sjellin së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme fetare, lehtësisht mund të organizoheshin fizikisht po të mos ishte për Covid-in.

Më 27 janar, para pak ditësh, ne përkujtuam Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit. Ditë kujtese, ku kujtesë do të thotë revanshi i jetës në rrjedhën e kohës; është si pus që thellohet në ndërgjegjen tonë prej të cilit mund të nxjerrim frymëzim dhe trimëri. Shohim aq shumë dhunë nëpër botë saqë rëndom përbën më lajm. Sa e sa herë kemi lexuar për vrasjen e njerëzve të pafajshëm në emër të mostolerancës?

Dhe përsëri, Shqipëria dëshmon një nivel të shkëlqyer tolerance që mund të shërbejë si shembull për shumë të tjerë.

Për t’iu kthyer thelbit të fjalës sime, edhe OSBE-ja ka shumë për t’i ofruar këtij debati. Përgjatë viteve, ne kemi zhvilluar angazhime domethënëse në lidhje me lirinë fetare, të cilat janë pjesë e kuadrit më të gjerë të parimeve dhe dispozitave të OSBE-së për luftën ndaj të gjitha formave të mostolerancës dhe diskriminimit, për përkrahjen e shtetit të së drejtës dhe respektit universal të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Çdo shoqëri që është më e drejtë, gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje është shoqëri e qëndrueshme dhe e sigurt, dhe madje jep kontribut për paqen dhe sigurinë në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar.

Puna e OSBE/ODIHR-it për luftën ndaj mostolerancës dhe krimeve të urrejtjes shihet gjerësisht si mjet i vlefshëm në dispozicion të Shteteve pjesëmarrëse. Që nga Akti Përfundimtar i Helsinkit i vitit 1975 deri tek Karta e Parisit për Evropën e Re (1990), detyrimi i Shteteve për të respektuar lirinë e fesë dhe besimit ka përbërë element qendror. Në Astanë, njëzet vite më vonë, shkuam më tej dhe miratuam Deklaratën: Drejtë Komunitetit të Sigurisë (2010), në të cilën, në vend se tu

kërkonte Shteteve pjesëmarrëse t'i respektojnë këto parime, OSBE-ja i ftoi të ndërmerrnin veprime konkrete, dhe këtu po citoj: *“duhen bërë përpjekje për të përkrahur lirinë fetare dhe të besimit dhe për të luftuar mostolerancën dhe diskriminimin.”*

Po puna jonë në terren?

Prezenca dhe institucionet shqiptare punojnë së bashku për të përkrahur bashkëpunimin ndërfetar dhe ndërbesimtar. Vitin e shkuar, teksa përkujtonim 75 vjetorin e lirit të Aushvicit, Kryesia Shqiptare e OSBE-së theksoi angazhimin e saj për shtimin e përpjekjeve për përkrahjen e dinjitetit njerëzor dhe përballjen me urrejtjen dhe gjuhën e urrejtjes kurdo dhe kudo që ajo ndodh.

Gjithashtu, më 4 shkurt të vitit 2020, Kryesia Shqiptare e OSBE-së organizoi një konferencë të nivelit të lartë, ku pjesëmarrësit bënë thirrje për përpjekje të bashkërenduara, duke përdorur edhe përvojat e komuniteteve të synuara, për të frenuar valën e antisemitizmit në rajonin e OSBE-së. Në fakt, që nga viti 2017, në përputhje me përpjekjet e saj për përkrahjen e pjesëmarrjes veprorë të qytetarëve dhe dialogun shumëkulturore, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe me Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit të Rinjve (RYCO), Prezenca e OSBE-së ka organizuar “Shtigjet Rinore: Përkrahja e Vlerave të OSBE-së në Ballkanin Perëndimor”. Çdo vit (përveç vitit 2020 për shkak të pandemisë), dhjetëra të rinj nga i gjithë Ballkani marrin pjesë në Shtigjet Rinore për të ndarë, për të krijuar rrjete dhe për tu angazhuar në veprimtari argëtuese dhe mësimore. Këto veprimtari theksojnë potencialin pasurues të forcimit të bashkëpunimit rajonal, ndër të tjera, edhe duke u angazhuar me të rinj dhe organizata përkatëse, siç është RYCO. Shtigjet Rinore u kanë dhënë mundësinë të rinjve të Ballkanit Perëndimor të mësojnë më shumë nga përvojat e njëri tjetrit, të organizohen pa paragjykim me njëri tjetrin dhe të nxisin ndërtimin rajonal të paqes, si pjesë e brezit të ri.

Shkëlqesi, zonja dhe zotërinj,

Vërtet besoj se nisma e sotme është shumë kuptimplotë. Ky rajon ka vetë përvojë historike me konfliktin dhe me hidhërimin, me mostolerancën fetare, me urrejtjen dhe diskriminimin. Ama, kësaj duhet t'i vijë fundi me anë të shembujve rajonalë dhe, në këtë pikë, Shqipëria ka shumë për të ndarë me të tjerët.

Fillesa e të drejtave dhe lirive individuale qëndron tek parimi i barazisë së të drejtave dhe tek dinjiteti ndërmjet të gjithëve. Ajo parakupton tolerancë të ndërsjellët për larminë dhe për dialogun ndërkulturore, edhe ndërmjet atyre sistemeve të vlerave të cilët janë të ndryshëm nga njëri tjetri, me kusht që dallimet të mos prekin vlerat e padiskutueshme.

Në fakt, vërtetë besoj se mund të jetojmë më mirë nëse jetojmë një jetë kuptimplotë dhe të thellë. Dhe bashkëpunimi më i madh ndërkulturore, ndërbesimtar dhe ndërfetar na ndihmon që jetët tona të jenë më të pasura.

Fund